REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

**VENDIM**

Nr.22, datë 07.02.2022

**PËR "NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 81, DATË 31.03.2021, "PËR CAKTIMIN E MASËS DISIPLINORE NDAJ PROKURORIT BUJAR MEMIA", TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË"**

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa "b", të Kushtetutës, në nenet 159, pika 2, germa "b", 189, pika 1, germa "a", 190, të Ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes se sistemit të drejtësisë", i ndryshuar dhe në nenin 157, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, me propozimin e Komisionit Disiplinor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

**VENDOSI:**

1. Në Vendimin nr. 81, datë 31.03.2021, "Për caktimin e masës disiplinore ndaj prokurorit Bujar Memia", të Këshillit të Lartë të Prokurorisë", pas paragrafit të dytë të pjesës urdhëruese (dispozitivit), të shtohet paragrafi, si vijon:

   *"-Pezullimin e përfitimit të pagës në masën 50 %, si dhe përfitimet e tjera të magjistratit, derisa vendimi të marrë formë të prerë."*

2. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë nga data 01.04.2021, datë në të cilën ka hyrë në fuqi Vendimi nr. 81, datë 31.03.2021, "Për caktimin e masës disiplinore ndaj prokurorit Bujar Memia", i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

3. Ky vendim i njoftohet Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Prokurorit të Përgjithshëm, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së parë Krujë dhe z. Bujar Memia.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

**KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË**

| | |
|---|---|
| **KRYETAR** | **ZV/KRYETAR** |
| **GENT IBRAHIMI** | **ALFRED BALLA** |

ANËTAR

SOKOL STOJANI

ANËTAR

BUJAR SHESHI

ANËTAR

NURIHAN SEITI

ANËTAR

ELOIDA GOXHI

ANËTAR

ESMERALDA KESHI

ANËTAR

LUDOVIK DODAJ

ANËTAR

ZEQIR HODA

ANËTAR

SANDËR BECI

ANËTAR

TARTAR BAZAJ